

Instituti GAP per Studime te Avancuara

# Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë

Analizë

Ky report është mundësuar me përkrahjen e Rockefeller Brothers Fund the UK Department for International Development (DFID)

Besiana Musmurati sapo ka mbaruar shkollën e mesme në Kosovë. Ajo duhet të bëjë një zgjedhje të vështirë që çdo maturant e ka në mend pasi të diplomojë. Çka pas kësaj? Si do të zgjedh ajo se çka do të studiojë? A do të marrë vendimin bazuar në atë se çka ajo dëshiron apo bazuar në atë se cila është mundësia më e mirë për të gjetur një punë? Edhe pse ajo ka vendosur që të bazohet në mundësinë më të mirë për të gjetur një punë, ajo akoma nuk ka informata të plota. Ajo nuk dëshiron që të shkojë në universitetin publik sepse mendon që ky universitet akoma nuk i ka përbushur reformat; po ashtu ajo beson se mësimdhënësit nuk janë shumë të përkushtuar. Ajo dëshiron të shkojë në një universitet privat. Si do të zgjedh ajo? Ku janë mësimdhënësit më të mirë? A janë prezentë ata në ligjérata? Sa seriozë janë ata në ligjérata? A janë ligjératat interesante? A e pasurojnë lëndët me shkathtësi që asaj i nevojiten që të gjejë një punë të mirë në Kosovë? A kanë kompjuterë? A kanë libra? Sa duhet që të paguajë? A do të mund ta shpaguajë edukimin e saj me punën që do të gjejë?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet që Besiana ka. Besiana është njëra prej 24,000 nxënësve që këtë vit mbarojnë shkollën e mesme. Mesatarisht, diku rreth 24,000 nxënës të shkollave të mesme do të diplomojnë çdo vit gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Ky raport është i motivuar nga këto tregime dhe përpinqet që të fillojë një diskutim i cili do të shpie deri te një përgjigje e këtyre pyetjeve

## Hyrje

Statistikat e fundit zyrtare të dhëna nga Enti i Statistikave të Kosovës në koordinim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale tregojnë se niveli i papunësisë në Kosovë është 44%.<sup>1</sup> Kjo shifër tregon përqindjen e njerëzve të cilët kërkojnë por nuk mund të gjejnë një vend të punës. Edhe pse të dhënat statistikore në Kosovë kanë një bazë të dobët, së paku ekziston një pajtim i përgjithshëm se në Kosovë shkalla e papunësisë është e lartë. Gjithashtu, statistikat e zhvillimit ekonomik tregojnë se rritja ekonomike në Kosovë ka qenë e një niveli mesatar. Trendet e rritjes ekonomike kanë qenë pozitive, por më të ulëta në krahasim me vendet e rajonit. Duke marrë parasysh rritjen vjetore të popullsisë prej 2%, përmirësimi në rritjen ekonomike për kokë banori ka qenë gati jo ekzistues.

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë. Rreth 70% e popullsisë janë nën moshën 30 vjeçare dhe rreth 50% e popullsisë janë nën moshën 25 vjeçare. Duket qartë se edhe nëse Kosova arrin nivelin rajonal të rritjes ekonomike, do të jetë vështirë që tregu kosovar të absorbojë të gjithë të rinjtë e aftë për punë. Është e qartë që Kosova ka nevojë për investime të huaja direkte dhe me qëllim që të arrijë këtë, Kosova ka nevojë për fillimin e reformave në sektorë të ndryshëm, të identifikojë mundësitet dhe avantazhet konkurruuese.

Ndonëse, shikuar në aspektin afat shkurtër, popullsia e Kosovës shihet si pengesë, në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë, popullsia e re e Kosovës përbën potencial të cilin askush në rajon nuk e

<sup>1</sup> Enti i Statistikës së Kosovës “Statistikat e tregut të punës 2006”, nëntor 2007

posedon. Kosova ka fuqi punëtore të cilën nuk e ka askush. Me qëllim që kjo pengesë të mund të kthehet në pasuri ose vlerë për Kosovën, duhet të synojmë që të përmirësojmë mënyrën e aftësimit të fuqisë punëtore. Politikat arsimore janë instrument kyç në përbushjen e këtij synimi. Politikat arsimore mund të përdoren për pasurimin e popullatës së re me aftësi që tregu i sotëm i kërkon. Përveç rëndësisë së arsimit fillor dhe të mesëm, arsimi i lartë luan një rol kyç. Universiteti i Prishtinës ka hasur në pengesa në përbushjen e kushteve të kërkesave të Deklaratës së Bolonjës, edhe pse ka kapacitete për absorbimin e 6,300 studentëve në vit.

Kohëve të fundit Kosova ka përjetuar një rritje të vrullshme dhe të papritur të institucioneve private të arsimit të lartë. Që nga 2001, 30 institucione të ndryshme kanë marrë licencën për punë, përderisa sot 24 prej tyre janë aktive. Nuk ekziston informacion i mjaftueshëm për cilësinë e këtyre institucioneve. Së fundi, Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka filluar procesin e ri-licencimit. Qëllimi i këtij raporti është ofrimi i më shumë informatave të cilat shpresojmë se do t'i shërbijnë cilësisë së debatit në këtë fushë. Momentalisht, institucionet private akomodojnë 19,000 studentë dhe për pak vite këto institucionë mund të arrijnë numrin e njëjtë të studentëve me Universitetin e Prishtinës. Megjithatë, shumë institucionë në Kosovë, duke përfshirë edhe institucionet publike, favorizojnë diplomat e marra jashtë vendit. Kuvendi i Kosovës, për shembull, kërkon juristë me diploma të universiteteve prestigjioze jashtë vendit, duke i anashkaluar institucionet vendore të arsimit të lartë.

Instituti për Studime të Avancuara GAP ka analizuar institucionet e arsimit të lartë dhe gjithashtu ka analizuar legislacionin në fuqi dhe zbatimin e tij. Duke përcjellë me vëmendje iniciativat e fundit të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT), kemi dhënë rekomandime për autoritetet përgjegjëse, të cilat besojmë se do të shpijnë në vendimmarrje të bazuara në më shumë informata.

### **Baza ligjore për funksionimin e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë**

Ligji për arsimin e lartë 2002/3, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25 korrik 2002 dhe i shpallur nga PSSP më 12 maj 2003 (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/14), vë bazat ligjore për funksionimin e arsimit të lartë në Kosovë. Disa nga objektivat e arsimit të lartë të përshkruara më ligj janë "krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njojurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore dhe shkencore; ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës të aftë për të përfituar nga ky arsim gjatë gjithë jetës së tyre." <sup>2</sup>

Sipas këtij ligji, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përmes udhëzimit administrativ, është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë në konsultim me bartësit e akredituar të arsimit të lartë. Ministria e Arsimit është gjithashtu përgjegjëse për krijimin e Agjencisë së

<sup>2</sup> Ligji mbi Arsimin e Lartë – Neni 2.1

Akreditimit të Kosovës për nxitjen e cilësisë së institucioneve private të arsimit të lartë përmes proceseve të licencimit, inspektimit dhe akreditimit të realizuara me anë të metodave profesionale.<sup>3</sup>

Në ligjin për arsimin e lartë, bartësit e arsimit të lartë janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë. Universiteti është një institucion mësimor dhe shkencor që jep diploma deri në nivel të doktoratës. Emërtimi ‘Universitet’ mund t’i jepet vetëm bartësve të akredituar të arsimit të lartë që ofrojnë kurse apo programe në të paktën 5 fakultete të ndryshme me së paku 600 studentë për secilin fakultet, gjithsej me së paku 3,000 studentë.

Ligji për arsimin e lartë lë hapësirë që përmes udhëzimeve administrative të rregullohen në mënyrë më specifike këto fusha: licencimi i bartësve privat të arsimit të lartë (neni 11.1); themelimi e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (neni 4.3); procedura për akreditim (neni 11.2); kryerja e vlerësimeve për cilësinë (neni 11.10); formati i diplomave (neni 12.7); përcaktimi i metodologjisë për caktimin e fondeve për institucionet private (neni 23.2); si dhe shumë udhëzime tjera administrative.

Sipas Urdhëresës Administrative të MASHT nr. 2003/14 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, çdo person privat, një organizatë apo fondacion i cili ka zyre të regjistruar në Kosovë, ka të drejtë të themelojë institucion privat të arsimit të lartë.<sup>4</sup> Një Bartës Privat i Arsimit t Lartë (BPAL) nuk mund të fillojë punën pa pasur paraprakisht licencën nga MASHT-i, por ai mund të shpallë konkurs dhe të pranojë studentë pasi të ketë filluar procedura e miratimit të licencës.<sup>5</sup>

Afati i licencës mund të zgjat tri deri në pesë vite me obligim që BPAL për çdo vit të bëjë përtëritjen e saj.<sup>6</sup> Kushtet për marrjen e një licence për një institucion, ndër të tjera janë: paraqitura e kërkesës për licencim, rregullorja për punë dhe kodi i mirësjelljes, lokal të mjaftueshëm, ambient me mjedis të shëndoshë dhe të sigurt, bibliotekën, kabinetet me pajisje kompjuterike, lista e punëtorëve mësimorë, lista e kuadrit administrativ, lista e botimeve shkencore të tyre, lista e literaturës që do të përdoret, etj.

<sup>7</sup>

Më 16 shkurt 2004, MASHT ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 2004/11 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK). Sipas këtij udhëzimi administrativ, MASHT do të themelojë një Agjenci që ushtron veprimitari të pavarur profesionale jo fitimprurëse, që të nxisë cilësinë në arsimin e lartë të Kosovës.<sup>8</sup> AAK është e përbërë nga struktura profesionale (Këshilli Kombëtar i Cilësisë) dhe struktura e përhershme administrative. Këshilli Kombëtar i Cilësisë përbëhet nga nëntë anëtarë të emëruar nga Ministria, prej të cilëve duhen të janë së paku tre përfaqësues që janë aktivë në punë akademike të arsimit të lartë, një përfaqësues i MASHT-it dhe tre ekspertë ndërkombëtarë.<sup>9</sup> Kryetari i Këshillit zgjidhet

<sup>3</sup> Ligji mbi Arsimin e Lartë – Neni 4.3

<sup>4</sup> Neni 2- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2003 mbi Licencimin e Bartësve Privatë të Arsimit të Lartë (17 korrik, 2003)

<sup>5</sup> Neni 7.3- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2003 mbi Licencimin e Bartësve Privatë të Arsimit të Lartë

<sup>6</sup> Neni 7.7 -Udhëzimi Administrativ nr. 14/2003 mbi Licencimin e Bartësve Privatë të Arsimit të Lartë

<sup>7</sup> Neni 8.1.1- Udhëzimi Administrativ nr. 14/2003 mbi Licencimin e Bartësve Privatë të Arsimit të Lartë

<sup>8</sup> Neni 2.1 dhe 2.2 i UA nr.11/2004 për Themelimin e Agjensisë së Akreditimit të Kosovës (AAK)

<sup>9</sup> Neni 5.1 i UA nr.11/2004 për Themelimin e Agjensisë së Akreditimit të Kosovës (AAK)

në një mandat pesëvjeçar. Struktura administrative kryen të gjitha punët administrative të AAK dhe udhëhiqet nga drejtori i zgjedhur përmes konkursit publik. Sipas nenit 9 të UA nr. 2004/11, një bartës i arsimit të lartë që kërkon akreditim për herë të parë bën një kërkesë pranë AAK të paktën një vit para datës së parashikuar për marrjen e akreditimit. AAK në afat brenda gjashtë muajsh merr vendim për akreditim ose mos akreditim të një institucionit. Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë dështon të akreditohet, AAK i kërkon MASHT-it të mos i njohë diplomat e atij institucionit, kurse kur një bartës i licencuar i arsimit të lartë akreditohet, atëherë AAK lëshon certifikatën për akreditim. Në rast të dështimit për akreditim, një bartës i licencuar i arsimit të lartë mund të përsëritë kërkesën për akreditim brenda një viti. Përndryshe, një dështim tjetër për ri-akreditim do të shpie në heqje të licencës. AAK boton materiale për sigurim të cilësisë dhe raporte të vlerësimit dhe akreditimit të cilat bëhen publike.<sup>10</sup>

Themelimi i AAK është zgjatur për katër vite duke rezultuar në licencimin dhe ri-licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë bazuar vetëm në kriteret e përgjithshme të përshkruar në urdhëresën administrative për licencim, pa ndonjë njohje në përbushjen e standardeve të cilësisë sipas procesit të akreditimit. Edhe pse AAK është themeluar në fillim të vitit 2008, ky institucion nuk do të jetë i përfshirë drejtëpërdrejtë në vlerësimin e bartësve privatë të arsimit të lartë në Kosovë për procesin e akreditimit. Më 30 janar 2008, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për krijimin e Komisionit të Akreditimit për Bartësit Privatë të Arsimit të Lartë, ku anëtarët e këtij komisioni do të jenë ekspertë nga universitetet ndërkombëtare<sup>11</sup> Duke u bazuar në këtë vendim të qeverisë, Ministria e Arsimit ka kontraktuar Këshillin Britanik për Akreditim që të vlerësojë cilësinë e bartësve privatë të arsimit të lartë në Kosovë dhe se cilët nga këta bartës do të licencohen dhe ri-licencohen. Sipas Ministrit të Arsimit, Enver Hoxhaj, pas procesit të vlerësimit të cilësisë, raporti i përgatitur nga Këshilli Britanik për Akreditim do t'i dorëzohet MASHT-it dhe AAK-së, ku Ministria do të formojë një komision që do të vendosë për licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë.<sup>12</sup>

Edhe pse Ligji për arsimin e lartë ka hyrë në fuqi para plotë pesë viteve (12 maj 2003), MASHT ende nuk i nxjerrë të gjitha urdhëresat administrative ashtu siç parashihet me ligj. MASHT ende nuk ka nxjerrë një urdhëresë administrative e cila do të përshkruante vlerësimin e cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.<sup>13</sup> OSBE, në tri raportet e saj për zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, kritikon MASHT-in për mos implementimin e Ligjit për arsimin e lartë në Kosovë.<sup>14</sup>

Shumë urdhëresa administrative nuk janë lëshuar nga MASHT-i siç parashihen me ligj, kurse shumë të tjera janë nxjerrë me vonesë dhe në masë të madhe janë të paqarta. Edhe pse qëllimi i këtyre udhëzimeve administrative është që të shërbejnë si plotësim i ligjit dhe të jalin më shumë detaje, ato në shumicën e rasteve janë ri-përsëritje e përbajtjes së ligjit.

<sup>10</sup> Neni 14 i UA nr.11/2004 për Themelimin e Agjensisë së Akreditimit të Kosovës (AAK)

<sup>11</sup> Neni 1 &2, Vendimi I Qeverisë 04/4 – 30 Janar, 2008

<sup>12</sup> Express, 17 Maj, 2008, faqe 6

<sup>13</sup> Neni 11.10 - Ligji mbi Arsimin e Lartë

<sup>14</sup> OSBE. Implementimi I ligjeve të Kuvendit të Kosovës (Raportet I, II, III).

Ligi mbi Arsimin e Lartë nuk është përbushur, veçanërisht sa i përket kritereve të licencimit. Për shembull, për universitetet thuhet se secili departament duhet të ketë 600 studentë, dhe se universiteti duhet të ketë së paku 5 departamente me 3,000 studentë gjithsej. Nëse këto do të ishin kushtet për tu licencuar si universitet, atëherë vetëm një nga dhjetë bartësit e licencuar si universitete do ta plotësonë kushtin sa i përket numrit të studentëve.

Në urdhëresën administrative nr. 14/2003 të lëshuar nga MASHT për licencimin e bartësve të arsimit të lartë, nuk janë të specifikuara qartë kriteret për licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë dhe gjithashtu këto kriterë janë subjektive. Po ashtu kriter i rëndësishëm për licencim është edhe lista e profesorëve dhe kualifikimet e tyre të cilat duhet t'i dorëzohen MASHT-it.<sup>15</sup> Mirëpo, nuk ka detaje të specifikuara se çfarë kualifikimesh duhet të ketë stafi akademik dhe administrativ p.sh. proporcioni i profesorëve me diploma të caktuara. Gjithashtu, hapësira specifike e objektit të bartësve privat të arsimit të lartë nuk është e përvkruar as në ligj dhe as në ndonjë udhëzim administrativ. Të kesh një ambient të shëndoshë dhe të sigurt është një deklaratë e përgjithshme dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme. Po ashtu nuk ka ndonjë numër të dhënë për klasa të ligjëratave dhe amfiteatreve në proporcionin student-klasë. Ka edhe shumë kriterë të tjera të cilat nuk janë të specifikuara dhe janë relative në interpretime të ndryshme subjektive dhe nuk cekin sasinë ose proporcionin, si:

- Hapësirë të mjaftueshme në bazë të standardeve ndërkombëtare;
- Bibliotekë me inventar dhe numër të pasur të librave të fushave të ndryshme;
- Kabinete të pajisura me kompjuterë;
- Ambient të përshtatshëm të punës;
- Laboratorë dhe pajisje të nevojshme për punë;
- Sigurimi i cilësisë së studimeve;

Situata e njëjtë mbretëron edhe në vendet rajonale si në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni dhe Serbi. Për shembull, ligji në Malin e Zi bën diferençimin në mes një universiteti dhe një institucion privat. Që një institucion të quhet universitet, duhet të ketë së paku pesë drejtime, prej të cilave tri duhet të janë nga këto lëmi: "shkencat shoqërore, njerëzore, inxhinieri, shkencat natyrore, arte, mjekësi dhe shkencat juridiko-ekonomike."<sup>16</sup> Mirëpo, ky ligj nuk saktëson numrin e studentëve që një institucion i arsimit të lartë duhet të ketë në mënyrë që të quhet universitet. Licencimi në Malin e Zi mund të jepet vetëm kur institucioni i arsimit të lartë merr certifikatën mbi akreditimin fillestar nga Këshilli i Arsimit të Lartë. Kriteret përmarrjen e licencës përfshijnë "hapësirë dhe pajisje të mjaftueshme, duke përfshirë klasat, laboratorët, bibliotekën dhe pajisjet kompjuterike; numrin dhe kualifikimet e stafit akademik; hapësira për studentë për aktivitete jashtë programit mësimor; dhe mjete financiare"<sup>17</sup>

## Çka Ofrojnë Bartësit Privatë të Arsimit të Lartë?

<sup>15</sup> Neni 8.1.1 i Udhëzimit Administrativ nr.14/2003 mbi Licensimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë

<sup>16</sup> Neni 37 i Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Malin e Zi

<sup>17</sup> Neni 25 i Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Malin e Zi

Tregu Kosovar numëron 24 institucionë të licencuara private të arsimit të lartë të cilat momentalisht janë aktive dhe funksionale, përderisa 10 institucionë janë të licencuara si universitete dhe pjesa tjeter janë të licencuara si kolegje, shkolla, fakultete, institute dhe akademi. Numri i përgjithshëm i të gjitha fakulteteve në institucionet private dhe universitete është 89 dhe brenda këtyre fakulteteve janë 150 drejtime (programe).

| Emri i Institucionit                                 | Lloji       | Vendi     | Numri i Fakulteteve | Numri i Programave | Numri i Studenteve |
|--|-------------|-----------|---------------------|--------------------|--------------------|
| 1 AAB  | Universitet | Prishtina | 6                   | 11                 | 4915               |
| 2 Akademia e Studimeve te Avancuara Universitare     | Akademi     | Prishtina | 1                   | 2                  | 30                 |
| 3 American University of Kosova                      | Universitet | Prishtina | 1                   | 2                  | 451                |
| 4 Amerikos   | Kolegj      | Prishtina | 1                   | 1                  | 28                 |
| 5 Biznes   | Kolegj      | Prishtina | 3                   | 9                  | 615                |
| 6 Dardania   | Universitet | Prishtina | 7                   | 22                 | 1514               |
| 7 Design Factory                                     | Shkolle     | Prishtina | 1                   | 1                  | 30                 |
| 8 Ekologji   | Fakultet    | Shterpce  | 1                   | 1                  | 48                 |
| 9 Eurosport  | Kolegj      | Prishtina | 1                   | 4                  | 79                 |
| 10 Evolucion   | Institut    | Prishtina | 5                   | 9                  | 56                 |
| 11 Fama  | Kolegj      | Prishtina | 5                   | 10                 | 4570               |
| 12 Gjilani   | Kolegj      | Gjilan    | 4                   | 8                  | 542                |
| 13 Iliria  | Universitet | Prishtina | 3                   | 6                  | 1838               |
| 14 Kolegji Univerzitar Ferizaji                      | Kolegj      | Ferizaj   | 3                   | 3                  | 255                |
| 15 Kosovo Institute for Journalism and Communication | Institut    | Prishtina | 2                   | 2                  | 74                 |
| 16 Pjetër Budi                                       | Universitet | Prishtina | 5                   | 11                 | 560                |
| 17 Rezonanca   | Universitet | Prishtina | 5                   | 5                  | 279                |
| 18 Riinvest  | Universitet | Prishtina | 3                   | 7                  | 126                |
| 19 Tempulli  | Kolegj      | Prishtina | 2                   | 5                  | 300                |
| 20 Universiteti i Prizrenit                          | Universitet | Prizren   | 7                   | 7                  | 457                |
| 21 Universiteti Internacional i Prishtines           | Universitet | Prishtina | 5                   | 5                  | 220                |
| 22 Universiteti per Biznes dhe Teknologji            | Universitet | Prishtina | 5                   | 5                  | 377                |
| 23 Universum   | Kolegj      | Prishtina | 5                   | 5                  | 486                |
| 24 Victory   | Kolegj      | Prishtina | 3                   | 3                  | 132                |
| 25 Vizioni Evropian                                  | Kolegj      | Peja      | 5                   | 9                  | 940                |
| <b>TOTAL</b>   |             |           | <b>89</b>           | <b>153</b>         | <b>18,922</b>      |

Institucionet private për arsimin e lartë në Kosovë ofrojnë programe në fusha të ndryshme; mirëpo më së shumti janë të fokusuara në programet në vijim (me një numër të përafërt të studentëve):

- Ekonomi (8,200 studentë),
- Juridik dhe të ngjashme (3,600 studentë),
- Administrim biznesi (1,100 studentë),
- Teknologji informative dhe të ngjashme (730 studentë),
- Kriminalistikë (690 studentë),
- Shkencë politike (570 studentë), dhe
- Psikologji (410 studentë).


Këto të dhëna tregojnë se ka pasur një kërkesë të lartë nga studentët të cilët kanë kërkuar të arsimohen në këto fusha. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se kërkesa e njëjtë ekziston edhe nga tregun i punës dhe ekonomisë në përgjithësi, e cila edhe më tutje mbetet një variabël e panjohur në Kosovë, pasi që nuk ka ndonjë studim në këtë drejtim. Një gjë duhet pasur parasysh që numri i studentëve i cekur më lartë pasqyron vetëm bartësit privatë të arsimit të lartë; nëse kësaj i shtojmë edhe numrin e studentëve që studiojnë në fusha të njëjtë në Universitetin e Prishtinës, atëherë rrjedh pyetja “a na nevojitet një numër kaq i madh i të diplomuarve në këtë apo atë fushë?”

Më shumë se gjysma e këtyre institucioneve kanë fakultete të ekonomisë dhe juridikut, si dhe drejtime të shumta juridike dhe ekonomike brenda këtyre fakulteteve. Fakultete të tjera të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë janë marrëdhëni ndërkombëtare, diplomacia, studime të edukimit, gjuhëve të huaja, gazetari, komunikim, media, shkencat e mjekësisë, shkencat e sportit, artet aplikative, posta dhe telekomunikacioni, transporti dhe rrugët, dogana dhe sigurime, burimet njerëzore etj.

### **Stafi Ligjérues**

Ekzistojnë shumë kushte dhe kriterë te cilat kontribuojnë në ngritjen e vlerës dhe cilësisë së arsimit tek bartësit e arsimit të lartë dhe stafi ligjérues sigurisht që është një ndër kriteret kryesore. Pasi që numri i studentëve ndryshon nëpër bartësit privatë të arsimit të lartë, numri i stafit ligjérues po ashtu ndryshon. Numri ndryshon prej 3 ligjérues (në një institucion me vetëm 30 studentë) e deri në 144 ligjérues (në një institucion me afro 5,000 studentë), duke pasur një proporcion ligjérues/student prej 1/3 deri ne 1/34. Sërisht, për arsyet e profileve të ndryshme të bartësve privatë, ekzistojnë proporcione të ndryshme ndërmjet ligjéruesve me doktoraturë, magjistraturë dhe ligjéruesve pa tituj akademikë. Sidoqoftë, proporcioni i përgjithshëm duke përfshirë të gjitha institucionet private tregon se shumica e ligjéruesve janë me doktoraturë, rrëth një e treta me magjistraturë dhe pjesa tjeter janë pa tituj akademikë.

### Proporcion i Ligjéruesve me Tituj Akademik



Edhe pse në përgjithësi gjërat duken në rregull, numri i përgjithshëm i ligjéruesve të cilët ligjerojnë në të 25 bartësit e arsimit privat është në mes 750 dhe 800. Edhe pse si numër mund të duket i mjaftueshëm sa i përket numrit të ligjéruesve, për gjithsej 19,000 studentë, problemi qëndron tek fakti që një numër i madh i këtyre ligjéruesve ligjerojnë në më shumë se një universitet, gjë e cila vë në dyshim cilësinë që ata mund ta ofrojnë gjatë ligjërimit. Për më shumë, tabela më poshtë pasqyron vetëm bartësit privatë të arsimit të lartë dhe nëse supozojmë se shumë nga këta ligjérues jepin mësim edhe në Universitetin e Prishtinës, atëherë numri i institucioneve ku ata ligjerojnë rritet edhe për një më shumë. Nga aspekti ligjor, ligji nuk e rregullon në asnjë mënyrë kufizimin e numrit të institucioneve në të cilat një profesor mund të ligjerojë.

| Kategoria                                 | Numri i Ligjéruesve |
|---|---------------------|
| Ligjérues që ligjerojnë ne 6 institucionë | 2                   |
| Ligjérues që ligjerojnë ne 5 institucionë | 4                   |
| Ligjérues që ligjerojnë ne 4 institucionë | 5                   |
| Ligjérues që ligjerojnë ne 3 institucionë | 22                  |
| Ligjérues që ligjerojnë ne 2 institucionë | 101                 |

## Plani Mësimor

Një tjetër kriter me rëndësi i cili kontribuon në cilësinë e arsimimit është plani mësimor në përgjithësi, dhe në veçanti mënyra se si është i dizajnuar dhe se si implementohet. Planet mësimore të fakulteteve të ndryshme të bartësve privatë të arsimit të lartë në Kosovë nuk ndryshojnë aq shumë ndërmjet institucioneve. Pothuajse të gjithë bartësit privatë ofrojnë studime të ekonomisë dhe juridikut, përderisa në anën tjetër shihet një rritje e interesimit për fushat si shkenca politike, komunikim masiv dhe kriminalistikë. Prej gjithsej 25 bartësve privatë të arsimit të lartë dhe universitetit publik, vetëm 3 bartës të arsimit të lartë kanë publikuar planin e tyre mësimor në ueb-faqet e tyre.

Kriteret për përpilimin e planit mësimor ndryshojnë nga një institucion në tjetrin dhe ato janë përzierje e praktikave evropiane dhe atyre amerikane. Bartësit privatë të arsimit të lartë në Kosovë, gjatë përpilimit të planeve mësimore, marrin për bazë kriteret në vijim:

- **Planet Mësimore te universiteteve tjera:**
  - Universiteti Amerikan ne Kosove (AUK) mbështetet në planin mësimor të Rochester Institute of Technology (RIT);
  - Kolegji Victory gjithashtu mbështetet në planin mësimor të institacioneve të huaja, me saktësishët të Universitetit të Shkencave Politike te Zagrebit dhe Universitetit Libertas;
  - Kolegji Universitar Gjilani mbështetet në planin mësimor të Universitetit të Prishtinës;
  - KIJAC (Kosovo Institute for Journalism and Communication) mbështetet në planin mësimor të Cardiff University, Nebraska University dhe Gimlekollen School of Journalism and Communication;
  - Universiteti Pjetër Budi mbështetet në planin mësimor të Universitetit Publik Saint Clement të Ohrit;
  - Universiteti Internacional i Prishtinës mbështetet në planin mësimor të Harvard University dhe Sheffield University;
- **Kërkesën e tregut:**
  - AUK;
  - Universiteti Universum;
  - Universiteti Biznesi;
  - Universiteti i Vizionit Evropian;
  - KIJAC;
- **Kushtet nga Sistemi I Kartës se Bolonjës:**
  - Universiteti Universum;
  - Universiteti AAB;
  - Kolegji Universitar Eurosporti;
  - Universiteti i Vizionit Evropian;
  - KIJAC;
  - Universiteti Pjetër Budi;
  - Universiteti Internacional i Prishtinës;

- Universiteti Riinvest;
- Propozimin e ligjëruesit te lëndës përkatëse:
  - Universiteti Dardania;

## Infrastruktura

Edhe pse jo të gjithë bartësit privatë të arsimit të lartë kanë qenë të gatshëm të shpalosin informatat rreth infrastrukturës së tyre dhe disa çështjeve tjera, pasqyra e pjesshme e infrastrukturës së shumicës së bartësve privatë në Kosovë jep rezultate mjaft interesante.

Përderisa numri mesatar i studentëve për një klasë (49) mund të duket i arsyeshëm, ekzistojnë disa institucionë në të cilat proporcioni është shumë më i favorshëm, me rreth 19 studentë për klasë, mirëpo ka edhe raste ku mund të ketë hapësirë të pamjaftueshme, me rreth 104 studentë për klasë. Kur marrim parasysh amfiteatrot dhe laboratorët, bartësit privatë të arsimit të lartë duken të janë më pak të ngjeshur, mirëpo duhet pasur parasysh edhe faktin që jo të gjitha institucionet kanë amfiteatro dhe laboratorë.

| Kategoria  | Mesatarja | Minimumi | Maksimumi |
|--|-----------|----------|-----------|
| Studentë për klasë   | 49        | 19       | 104       |
| Studentë për hapësire ligjëruese (klasa, amfiteatro, laboratorë) | 32        | 9        | 72        |
| Zyra për staf  | 9         | 1        | 25        |
| Libra në Gjuhën Shqipe   | 853       | 0        | 6057      |
| Libra në Gjuhën Angleze  | 470       | 0        | 2200      |
| Libra në gjuhë të tjera  | 129       | 0        | 1000      |
| Studentë për kompjuter   | 26        | 1        | 300       |
| Kompjuterë për staf  | 19        | 1        | 80        |

Bartësit privatë të arsimit të lartë në përgjithësi kanë numër të mjaftueshëm të librave, mirëpo duke u bazuar në shënimet e mbledhura gjatë humumtimit, janë disa institucionë të cilat nuk kanë asnjë libër në dy gjuhët kryesore (Gjuhë Shqipe dhe Gjuhë Angleze). Në anën tjetër, ekzistojnë institucionë të cilat sipas tyre posedojnë deri ne 6,000 libra vetëm në Gjuhën Shqipe.

Mesatarisht, bartësit privatë të arsimit të lartë ofrojnë një kompjuter për rreth 26 studentë. Mirëpo, ekzistojnë disa institucionë të cilat mund të ofrojnë një kompjuter për 1-2 studentë, si dhe disa institucionë të tjera të cilat mund të ofrojnë vetëm një kompjuter për 300 studentë.

## Shumë universitete?

Rritja e numrit të institucioneve private të arsimit të lartë ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të studentëve. Me rritjen e numrit të institucioneve private të arsimit të lartë është rritur gjithashtu edhe numri i studentëve të regjistruar në këto institucione. Kahasuar me regionin Kosova është pak a shumë në nivelin e njëjtë me disa nga shtetet e rajonit. Sidoqoftë, vetëm numri i studentëve nuk është një tregues i mirë për nivelin dhe kualitetin e edukimit në këto institucione. Kosova ka rreth 27,000 studentë në institucionin publik të arsimit të lartë, Universitetin e Prishtinës<sup>18</sup>. Janë mbi 18,000 studentë në institucionet private të arsimit të lartë, që së bashku përbëjnë totalin prej 45,000 apo përafërsisht 2,250 studentë për 100,000 banorë (nëse marrim që Kosova ka një popullatë prej 2 milion banorësh). Tabela e mëposhtme tregon numrin e studentëve për 100,000 banorë në shtetet në region dhe në shtetet e zhvilluara.

| Shteti    | Numri i studentëve në arsimin e lartë | Vlerësimi i popullsisë (në miliona) | Numri i studentëve për 100,000 banorë |
|-----------|---------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------|
| Shqipëria | 86,178                                | 3.14                                | 2,749                                 |
| Maqedonia | 57,011                                | 2.04                                | 2,793                                 |
| Serbia    | 238,710                               | 7.40                                | 3,226                                 |
| Bosnja    | 93,686                                | 4.31                                | 2,173                                 |
| Kosova    | <b>46,196</b>                         | <b>2.00</b>                         | <b>2,310</b>                          |
| Franca    | 2,254,000                             | 63.57                               | 3,546                                 |
| Gjermania | 1,979,043                             | 82.32                               | 2,404                                 |

Që nga viti 2002 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka licencuar 30 institucione të arsimit të lartë në Kosovë. Aktualisht 24 nga këto janë aktive si institucione që u ofrojnë mësimë studentëve dhe kanë studentë të regjistruar. Të tjerëve, ose u ka skaduar licenca ose nuk kanë filluar ende punën. Është vetëm një institucion i cili nuk ka aplikuar për licencë.

Ndonëse shumë nga këto institucione nuk përbushin kriteret për t'u quajtur universitete dhe nuk janë licencuar si universitete, në emërtimet e tyre ato ende mbajnë titullin "universitete". Mund të numërojmë 89 departamente dhe 150 drejtime. Kahasuar me regionin ky numër është shumë i lartë.


## Pse kjo rritje në numra?

Nga 24 institucionet aktive të licencuara të arsimit të lartë është vetëm një institucion që klasifikohet si institucion jo-fitimprurës. Të gjitha institucionet tjera kanë pronarë privatë dhe aq sa janë ndërmarrje biznesi janë edhe institucione të arsimit të lartë. Sidoqoftë, duhet të cekim se kjo nuk është dukuri e padëgjuar në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Edhe pse shumica e universiteteve me famë botërore janë institucione jo-publike, ka ende shumë universitete në botë, përfshirë vendet e zhvilluara, ku universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë ndërmarrje fitimprurëse.

<sup>18</sup> SOK, Statistikat mbi edukimin 2006/2007; kjo nuk përfshinë numrin e studentëve ne Universitetin e Mitrovicës.

Në Kosovë, sektori i arsimit të lartë privat ka vlerë rreth 26.5 milion Euro. Kjo është shuma që studentët kanë paguar për arsimimin e tyre në këto institucione gjatë vitit 2007. Pagesa për një vit studimi në këto institucione sillet prej 900€ – 5,150€. Të ardhurat që disponon sistemi i arsimit e kanë nxitur hapjen e institucioneve të reja.

Nëse shikojmë numrin e studentëve që janë në shkollë fillore dhe atë të mesme, numri mesatar i studentëve që do të mbarojnë shkollimin e mesëm në 10 vitet e ardhshme është afro 24,000 studentë në vit; kjo duke u bazuar në strukturën e popullatës dhe trendet e viteve të kaluara. Natyrisht, jo të gjithë do të janë të interesuar t'i vazhdojnë studimet universitare; sidoqoftë, sistemi i arsimit privat ka qenë në gjendje që në sistemin e tij t'i térheqë 19,000 studentë. Universiteti i Prishtinës absorbon afro 6,300 të diplomuar çdo vit. Pjesa tjeter e mbetur zgjedh sistemin privat të edukimit apo kërkojnë punësim.



## Arsyet për rritjen e numrit të studentëve në sistemin e arsimit privat

Ka shumë arsyet pse të diplomuarit e shkollimit të mesém janë në kërkim të arsimimit të lartë dhe veçanërisht në institucionet e arsimit privat:

*Papunësia* – Momentalisht, shkalla zyrtare e papunësisë në Kosovë është 44%, me një trend në rritje. Një numër i madh i popullsisë së re të Kosovës i shtohet tregut të punës për çdo vit. Rritja aktuale ekonomike e Kosovës nuk ka kapacitete për absorbimin e këtyre personave që hyjnë në treg çdo vit. Kur një i diplomuar i shkollës së mesme shqyrton mundësitë e tij/saj ai/ajo ka dy zgjedhje: a) të kërkojë punë me shpresë që do ta gjejë një, apo b) të vazhdojë arsimin universitar me shpresë që diploma do t'i rrisë mundësitë për punësim. Aktualisht, zgjedhja e parë është mundësi vetëm e një numri të kufizuar të njerëzve. Të tjerët konsiderohen si të papunësuar apo studentë universitar. Aktualisht, më shumë njerëz zgjedhin opzionin e dytë.

*Universiteti i Prishtinës* – Vetëm 6,300 studentë pranohen në Universitetin e Prishtinës dhe shijojnë përparësitë e një sistemi jo të shtrenjtë të edukimit. Ka shumë raste kur studentët që kanë kushte të mira materiale kërkojnë kushte më të mira për të studiuar, arsimim më kualitativ, profesorë më të motivuar për punë të cilët paguhen më mirë sesa në Universitetin publik të Prishtinës. Të tjerëve u duhet të kërkojnë punë. Përderisa ky raport nuk ka analizuar cilësinë e mësimdhënies në Universitetin e Prishtinës, qëllimi për të marrë edukim më cilësor motivon shumë studentë të zgjedhin universitetet tjera.

*Mundësia për të studiuar në një universitet më të mirë* – Ka shumë raste ku studentët, të cilët kanë mundësi më të mira ekonomike janë në kërkim të një arsimimi më të mirë, kushte më të mira dhe profesorë më të motivuar, të cilët janë më të paguar në universitete private sesa në Universitetin e Prishtinës. Përderisa ky raport nuk ka analizuar kualitetin e mësimeve dhe lëndëve të ofruara në këtë universitet, synimi për një arsimim më të mirë padyshim shihet të jetë motivimi i studentëve për t'i zgjedhur këto universitete.

*Orë mësimore fleksibile* – Me qëllim të térheqjes së studentëve të punësuar, të cilët mund t'ia lejojnë vites një edukim më të shtrenjtë, shumica e institucioneve private të arsimit të lartë janë duke ofruar më shumë mënyra fleksibile të studimeve, nga ligjérata e mbrëmjes e deri tek opzionet fleksibile për provime.

*Fokusimi në diplomë* – Kur papunësia në një shtet është e madhe ka shumë kërkesa për një vend pune. Si rezultat, kriteret për çdo vend pune rriten. Diploma universitare bëhet parakusht për pothuajse çdo vend pune. Kështu është gjendja në shumë konkurse për punë të cilat i shpallë qeveria. Një kandidat i aftë mund të largohet nga konkurenca nëse ai/ajo nuk ka diplomë universitare, edhe pse ai/ajo mund të jetë zgjedhje më e mirë për atë pozitë. Ka shumë raste kur njerëzit që kanë punuar nëpër organizata te huaja nuk mund të pranohen në punë në qeveri për arsyet të nivelit të arsimimit formal, edhe pse ata janë më të mirë se kandidatët e tjerë. Në kësot situata, njerëzit shikojnë vetëm si të arrijnë tek diploma me qëllim që t'u figurojë në CV e tyre. Nëse parakusht i domosdoshëm është diploma universitare,

atëherë vëmendja përqendrohet në nivelin e arsimimit dhe jo në kualitetin e arsimimit që ata marrin në këto institucionë.

### **Rruga përpresa**

Përderisa zhvillimi ekonomik nuk përmirësohet brenda natës, papunësia do të vazhdojë të jetë një problem në vitet në vijim dhe ekonomia nuk do të përvetësojë hyrjet e reja në tregun e punës. Ne presim që kërkesa për arsimin në institucionet private, nëse nuk rritet, të paktën të jetë e njëjtë.

Një nga potencialet më kryesore të Kosovës është popullata e re. Megjithatë, për shkak të nivelit të tanishëm të papunësisë, si dhe nivelit të tanishëm të zhvillimit ekonomik, popullata e re konsiderohet më tepër si përgjegjësi sesa pasuri. Në aspektin e arsimit të lartë, përqendrimi duhet të jetë në cilësinë e edukimit që më së miri di të pajisë punëtorët e rinj me aftësitë që janë të nevojshme për tregun e sotëm.

### Dy mundësi

Janë dy mënyra të përgjithshme përmes të cilave mund të ndërtohet rruga e mëtutjeshme.

1. Tregu përcakton cilësinë e universiteteve.

Kjo do të thotë që pothuajse të gjithë ata që aplikojnë për licencë dhe i përbushin kriteret bazë për t'u bërë një institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë marrin licencën dhe akreditohen. Tregu do të rregullohet vetveti. Kjo lë të kuptohet që bazuar në cilësinë e institucioneve, kërkesa për atë institucion do të ndryshonte. Nëse cilësia dhe kushtet nuk janë të mira në një institucion, çdo herë e më pak studentë do të shkonin në atë universitet, derisa ai universitet do të detyrohej të përjashtohej nga tregu. Nëse cilësia është e mirë dhe përshtypja është që universiteti ofron vlerë për para si këmbim, atëherë çdo herë e më shumë studentë do të interesoheshin për të studiuar në atë institucion.

Megjithatë, në këtë zgjedhje, ndodh një dështim i tregut që duhet të adresohet. Me një rast klasik të asimetrisë së informacionit, të diplomuarit e shkollës së mesme nuk kanë informata të plota rreth cilësisë së një institucionit që kërkohet për marrjen e vendimit se ku të shkojnë. Aktualisht ata bazohen në fjalët apo thashethemet nga studentët që studiojnë në ato institucionë, si dhe në perceptimin e përgjithshëm nga shoqëria rreth një institucionit. Roli i qeverisë në këtë rast do të ishte që t'i ofrojë këto informata publikut në mënyrë që tregu të mund të funksionojë më mirë.

Kjo mund të arrihet përmes një sistemi të klasifikimit që mund të bëhet ose nga organi i akreditimit (duke e implementuar ligjin mbi arsimin e lartë, kapitulli mbi vlerësimin e cilësisë) ose nga një sistem vetëregullues i cili do të administrohej nga një lloj asociacioni i institucioneve të arsimit të lartë privat në Kosovë. Një proces cilësor i vlerësimit do të duhej të përfshinte edhe kriterin e gradimit për secilin universitet, duke u bazuar në përmbushjen e disa kritereve të caktuara. Ky vlerësim do të bëhej çdo vit dhe do të ishte një metodë transparente për dhënien e informatave studentëve për cilësinë e universiteteve. Kjo gjithashtu do të shërbente si nxitës për universitetet në përmirësimin e shërbimeve që ata ofrojnë. Ligji në fuqi ka dispozita të këtij lloji, por implementimi nuk është bërë asnjëherë. Sipas ligjit, Agjencia për Akreditim e Kosovës duhet të vlerësojë cilësinë e institucioneve private të arsimit të lartë dhe ta bëjë publik rezultatin e vlerësimit. Ne do të kualifikonim atë kërkesë në një lloj vlerësimi të standardizuar që do të mund të bëhej çdo vit, nga organi i akreditimit ose nga një institucion i pavarur i caktuar nga asociacioni i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

## 2. Kriteri i licencimit/akreditimit është i rreptë dhe qeveria mbyll institucionet që nuk i përmbushin kriteret.

Në këtë rast, qeveria do të luante rolin e një filtri të cilësisë dhe do të mbylli institucionet e arsimit të lartë që nuk i përmbushin kriteret. Në këtë mënyrë, institucionet përgjegjëse duhet të bëjnë kriterin e licencimit më konkret se që është tani. Qeveria duhet të specifikojë infrastrukturën që kërkohet, numrin e profesorëve me titull të caktuar dhe kritere të tjera që kërkohen.

Në këtë mundësi, qeveria duhet të mendojë rreth studentëve që studiojnë momentalisht në institucionet private të arsimit të lartë që nuk i përmbushin kriteret e rrepta për tu bërë universitet. Duhet të ekzistojë një zgjidhje që do të siguronte që investimi i tyre paraprak nuk do të humbe.

Nëse Agjencia e Akreditimit do të veprojë bazuar në këtë opsjon, rekomandohet që institucioni i akreditimit të ofrojë një periudhë kohore për përmirësimë në ata bartës të arsimit të lartë, të cilët nuk i përmbushin kushtet për akreditim. Për shembull, nëse një institucion arsimor nuk i përmbush kriteret e licencimit, atëherë atij institacioni duhet bërë me dije se në cilat fusha ka ngecje dhe t'i jepet një kohë e caktuar gjatë së cilës institacioni do të përmirësojë disa kushte. Gjithashtu institucionit arsimor duhet bërë me dije se do të mbyllët në rast se nuk i përmbush kriteret për një kohë të caktuar.

## Rekomandime

